

DEKLARATA EGLADBECK-UT

SI DËSHIROJMË TË JETOJMË ME NJËRI-TJETRIN NË TË ARDHMEN

Ne deklarojmë se kemi vlera të përbashkëta, mbi bazën e të cilave bashkëjetojmë.

Baza për këtë është kushtetuta dhe rendi themelor i lirë demokratik i Republikës Federale të Gjermanisë. Të gjithë personave që banojnë dhe punojnë në Gladbeck u kërkohet të jetojnë dhe zbatojnë në mënyrë aktive këto vlera!

Ne jemi një qytet i hapur dhe tolerant, në të cilin sillemi me respekt dhe në mënyrë miqësore me njëri-tjetrin. Kjo përfshin faktin që ne respektojmë njëri-tjetrin, pavarësisht nga origjina, moshë, seks, feja, pamja e jashtme, situata ekonomike, orientimi seksual ose aftësia e kufizuar. Në vend që ta kufizojmë njëri-tjetrin, ne sillemi në mënyrë të sigurtë dhe plot besim mes nesh dhe kemi interes te njëri-tjetri.

Ne kontribuojmë në mënyrë aktive në projektimin e bashkëjetesës sonë. Këtu duhet të veprojnë të gjithë sipas dëshirave dhe aftësive të veta. Ndërkaq, ne jemi të hapur ndaj personave të rinj që vijnë te ne.

Ne jemi një qytet ku jetojmë në mënyrë solidare me njëri-tjetrin. Duke u mbështetur në traditat tona, ne ndihmojmë njëri-tjetrin. Lejohet shfaqja e pikave të dobëta dhe të gjithë personat që janë në nevojë marrin mbështetjen që u nevojitet.

Ne shohim dhe çmojmë gjerat pozitive në qytetin tonë dhe shërbimet që sjellin të gjithë në jetën e tyre dhe për të tjerët.

Respekti tregohet jo vetëm ndaj njerëzve, por edhe ndaj vendeve, rrugëve tona, parqeve, shkollave, vendeve të lojërave dhe sportit. Me to sillemi me respekt. Ato janë vendet tona, janë shtëpia jonë. Këtu, mbrojtja e ambientit tonë është një e mirë veçanërisht e madhe, ne e mbrojmë atë së bashku.

Për ne është e rëndësishme të tregojmë respekt për njëri-tjetrin, si në hapësirën publike, ashtu dhe në atë private. Të gjithë kanë të drejtë të jetojnë në paqe, të qetë dhe të pashqetësuar. Liria individuale mbaron aty ku fillon liria e të tjerëve.

Ne jetojmë së bashku në paqe dhe siguri. Konflike do të ketë gjithmonë, por ne do t'i zgjidhim ata në mënyrë paqësore dhe me fjalë, pa dhunë. Problemet do të tregohen pa lënduar njëri-tjetrin, qoftë në bisedën direkte, apo në mediat sociale.

Diskriminimin, racizmin dhe populizmin e djathtë e refuzojmë. Ne kemi guximin t'i kundërshtojmë me kurajë civile.

Te gjithë ne jemi përgjegjës që t'i jetojmë me njëri-tjetrin këto vlera!
Qëndrojmë gjithmonë të hapur t'i negociojmë së bashku vlerat e përmendura në këtë deklaratë,
kur kjo na duket e drejtë.

Sepse: Gjërat e reja sjellin gjithmonë një shans, të cilin ne në Gladbeck e pranojmë me guxim dhe optimizëm.